

RELACION

PËR PROJEKTLIGJIN “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E INSTITUCIONEVE PËR TË LUFTUAR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR”

Përmbledhje:

Ky ligj është hartuar për të vënë në zbatim ndryshimet kushtetuese të Neneve 135 dhe 148, si dhe shtimin e Nenit 148/dh. Këto nene të reja krijojnë një gjykatë dhe prokurori të dedikuar vetëm për hetimin, ndjekjen penale dhe gjykimin e korrupsionit, krimin të organizuar si dhe të gjitha veprave penale nga zyrtarë të kaluar dhe aktualë të nivelit të lartë, sipas Nenit 135, paragrafi 2 të projekt-Kushtetutës. Ai normon edhe organizimin dhe funksionet e Strukturës së Posaçme Anti-Korrupsion (SPAK), e cila përbëhet nga Prokuroria e Posaçme dhe Byroja Kombëtare e Hetimit, të cilat krijohen dhe normohen me projekt Nenet 148 e 148/dh të Kushtetutës.

Neni 1

Objekti i ligjit

Ky nen përshkruan objektin e ligjit, i cili është përcaktimi i rregullave për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë së Posaçme dhe Byrosë Kombëtare të Hetimit. Ai jep më shumë hollësi në lidhje me kushtet e sigurisë që duhet të përmbushin gjykatësit, prokurorët, hetuesit dhe personeli i BKH-së për të punuar në Gjykatat e Posaçme apo SPAK. Gjithashtu përcakton kompetencat e Prokurorisë së Posaçme në raport me Kodin e Procedurës Penale, përfshirë kompetencat e saj dytësore për të hetuar veprat penale të lidhura.

Neni 2

Qëllimi i Prokurorisë së Posaçme

Ky nen përshkruan qëllimin e Prokurorisë së Posaçme, që është pasja e një prokurorie të përgjegjshme dhe të specializuar për të hetuar dhe ndjekur penalisht në mënyrë efektive çështjet e vështira të korrupsionit dhe krimin të organizuar, si dhe krimet e kryera nga zyrtarë të rëndësishëm, në mënyrë të pavarur dhe pa asnjë ndikim të papërshtatshëm. Kjo shpjegon se si prokuroria duhet të jetë e pavarur mjaftueshëm sa të jetë në gjendje të përqendrohet tek çështjet e korrupsionit, krimin të organizuar si dhe në krimet nga persona të cilët mund të kenë pushtetin apo ndikimin për të ndaluar një hetim.

Neni 3

Qëllimi i njësisë së pavarur hetimore

Ky nen përshkruan qëllimin e një njësie të pavarur hetimore. Kjo njësi përmendet në Kushtetutë tek Neni 148, i cili përcakton se një njësi e pavarur hetimore varet nga Prokuroria e Posaçme. Kjo njësi, e cila në Nenin 4 të këtij ligji quhet “Byroja Kombëtare e Hetimit” është një njësi e përgjegjshme dhe e specializuar për të kryer hetime efektive të çështjeve të vështira të

korrupsionit, krimit të organizuar si dhe krimet e kryera nga zyrtarë të rëndësishëm, në mënyrë të pavarur dhe pa asnjë ndikim të papërshtatshëm. Kjo shpjegon se si njësi duhet të jetë e pavarur mjaftueshëm sa të jetë në gjendje të përqendrohet tek çështjet e korrupsionit, krimit të organizuar si dhe në krimet nga persona të cilët mund të kenë pushtetin apo ndikimin për të ndalur një hetim.

Neni 4

Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar

Ky nen përshkruan marrëdhënien mes Prokurorisë së Posaçme dhe Byrosë Kombëtare të Hetimit nën varësinë e saj. Sëbashku, këto dy organe janë një institucion, i titulluar Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, i cila është quajtur gjerësisht "SPAK". Nenet 148 dhe 148/dh të Kushtetutës nuk i vendosin emër Njesisë së Pavarur Hetimore, por në këtë nen njësi quhet "Byroja Kombëtare e Hetimit". Neni 5 dhe 6 i përshkruajnë dy organet veç e veç.

Neni 5

Prokuroria e Posaçme

Ky nen përshkruan funksionin e Prokurorisë së Posaçme dhe marrëdhënien e saj me Gjykatat e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar si dhe me Gjykatën e Lartë. Për çështjet brenda kompetencave të Prokurorisë së Posaçme, ajo përfaqëson akuzën përpara këtyre gjykatave. Kjo garanton që këto ndjekje penale të jenë të pavarura, pasi të paturit e kontrollit përfundimtar të ndjekjeve penale brenda Gjykatës së Lartë është një formë varësie mbi një organ tjetër prokurorie. Ky nen përshkruan edhe marrëdhënien me Këshillin e Lartë të Prokurorisë, i cili emëron prokurorët në postet e prokurorëve të posaçëm. Hollësitë në lidhje me Prokurorinë e Posaçme jepen në nene të tjera të këtij ligji.

Neni 6

Byroja Kombëtare e Hetimit

Ky nen përshkruan strukturën bazë të Byrosë Kombëtare të Hetimit (BKH). BKH është një seksion i specializuar i policisë gjyqësore nën varësinë e Prokurorisë së Posaçme. Në mënyrë që të ruhet një marrëdhënie operationale dhe informuese me shërbime të tjera policore, sidomos për operatione që kërkojnë shumë punë, si kontrole të befasishme, vëzhgime apo arrestime, ka edhe shërbime të policisë gjyqësore. Këto shërbime të policisë gjyqësore varen edhe nga Prokuroria e Posaçme. Ky ligj është hartuar në mënyrë të atillë që të jetë në përputhje me Projektligjin për Policinë Gjyqësore. BKH dhe shërbimet e saj të policisë gjyqësore hetojnë veprat penale që janë në juridiksionin e Prokurorisë së Posaçme. Hollësitë në lidhje me BKH dhe Shërbimet e saj të Policisë Gjyqësore jepen në nene të tjera të këtij ligji.

Neni 7

Juridiksioni kombëtar

Ky nen përshkruan juridiksionin e Gjykatave kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK). Juridiksioni përfshin të gjithë Shqipërinë. Gjykatat dhe Prokuroria e Posaçme e kanë vendndodhjen në Tiranë. Edhe BKH do të ndodhet në Tiranë, por është e autorizuar të krijojë zyra të përkohshme apo të përhershme jashtë Tiranës për të përmbushur qëllimin e saj.

Ky nen i jep fleksibilitet BKH-së, e cila mund të ngrëjë zyra në mënyrë që të kryejë hetime specifike, ose mund të krijojë nën-zyra të vogla në të ardhmen, për të lehtësuar rolet e saj për hetimin dhe mbledhjen e informacionit.

Neni 8

Kushtet e sigurisë para caktimit në detyrë apo emërimit

Nenet 135 dhe 148/dh të Kushtetutës parashikojnë që kandidatët për gjyqtarë në gjykatat kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme, si dhe për personel në Prokurorinë e Posaçme e në Byronë Kombëtare të Hetimit, e po ashtu edhe familjarët e tyre të afërm, duhet të plotësojnë kushte sigurie. Në këto kushte përfshihet një shqyrtim i pasurive të tyre dhe një verifikim figure. Për më tepër, ata duhet të pranojnë tu nënshtrohen kontrolleve periodike të llogarive të tyre financiare dhe telekomunikimeve personale. Ky nen i përshkruan këto kushte më në hollësi, dhe nuk lejon që asnjë kandidat të emërohet apo punësohet pa plotësuar këto kushte. Ministria e Drejtësisë kishte propozuar që kushtet të zbatoheshin vetëm për “çdo punonjës të Prokurorisë së Posaçme apo të Byrosë Kombëtare të Hetimit, i cili ushtron një funksion hetues, apo detyra e të cilit është në mbështetje të drejtpërdrejtë të procesit hetimor”. Projekt-amendamentet e Kushtetutës tek Neni 148/dh në formën e tij përfundimtare thjesht parashikojnë që “personeli në Prokurorinë e Posaçme dhe Njësinë e Pavarur Hetimore” si dhe familjarët e tyre të afërm duhet të përmbushin këto kushte sigurie. Dispozitat kushtetuese zbatohen tek i gjithë personeli, ndërsa versioni i propozuar nga Ministria e Drejtësisë duket se përfshin të gjithë personelin, por mund të lërë jashtë punonjës si pastrueset apo punëtorët e mirëmbajtjes.

Kandidatët duhet të dorëzojnë deklarata pasurie dhe konflikti interesi tek Inspektoriati i Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe Konfliktin e Interesave, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Kryeinspektori ka katër muaj kohë për të kontrolluar deklaratat dhe për t'i dorëzuar një raport dhe një opinion autoritetit që i cakton në detyrë apo merr në punë, lidhur me faktin nëse deklaratat janë të plota dhe nëse kandidati ka pasuri që janë të padeklaruara apo të pajustificuara nga të ardhurat e ligjshme. Ky autoritet do të ishte Këshilli i Lartë i Prokurorisë për prokurorët, Këshilli i Lartë Gjyqësor për gjyqtarët, si dhe strukturat e përcaktuara në këtë ligj për Byronë Kombëtare të Hetimit. Një kandidat i cili e ka kaluar një audit brenda 6 muajve përpara aplikimit nuk është i detyruar t'i nënshtrohet këtij hapi. Qëllimi i këtij hapi është të përcaktojë nëse në rastin e kandidatit ka prova për korrupsion në formën e pasurisë së padekluar apo të pashpjegueshme.

Në mënyrë të ngjashme, kandidati plotëson dhe dorëzon në Autoritetin e Sigurisë Kombëtare një pyetësor sigurie, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Brenda 90 ditëve, Drejtori i Autoritetit të Sigurisë Kombëtare i paraqet një raport autoritetit që i cakton në detyrë apo merr në punë, lidhur me faktin nëse pyetësi ishte plotësuar në mënyrë të saktë si dhe i tregon çdo shqetësim që mund të burojë nga hetimi i verifikimit të figurës. Ky autoritet do të ishte Këshilli i Lartë i Prokurorisë për prokurorët, Këshilli i Lartë Gjyqësor për gjyqtarët, si dhe strukturat e përcaktuara në këtë ligj për Byronë Kombëtare të Hetimit. Qëllimi i këtij kontrolli është të sigurohet se aplikuesit nuk kanë lidhje me grupe kriminale apo burime të tjera ndikimi të papërshtatshëm.

Së fundmi, kandidatët duhet të plotësojnë një deklaratë me shkrim, të nënshkruar nga kandidati dhe anëtarët e afërt të familjes, sipas së cilës, nëse caktohen në detyrë apo merren në punë, telekomunikimet e kandidatit do të jenë objekt vëzhgimi dhe se ata heqin dorë nga e drejta e jetës private lidhur me këto komunikime. Kjo është e ngjashme me marrëveshjet e nënshkruara nga gjyqtarët dhe prokurorët e emëruar në USKOK të Kroacisë dhe DNA të Rumanisë. Kjo është bërë me qëllim që të dekurajohet kontaktimi i gjyqtarëve apo prokurorëve me synime korruptive apo kërcënimi. Aksesit në kohë reale i të dhënave financiare, përkundrejt thjesht mbështetjes tek deklaratimet e pasurive, mund të zbulojë shpenzim të pazakonta, depozita dhe blerje të pashpjeguara, si dhe tregues të tjerë korrupsioni.

Neni 9

Përkufizimet

Ky nen jep përkufizimet për terma të ndryshëm të përdorur në ligj. Në veçanti, ai përkufizon edhe një dispozitë kushtetuese. Ai përkufizon “drejtuesit e institucioneve qendrore ose të pavarura shtetërore”, të cilët Neni 135 i projekt-Kushtetutës i lë të përkufizohen me ligj.

KREU II

KOMPETENCAT

Neni 10

Kompetenca parësore

Ky nen përshkruan kompetencat parësore të Gjykatave kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar si dhe të Prokurorisë së Posaçme. Për shkak se kompetencat e një gjykate apo prokurorie përcaktohen në Kodin e Procedurës Penale, për Nenin 75/a të Kodit të Procedurës Penale u propozua një grup i veçantë ndryshimesh. Është shumë e rëndësishme edhe që KPP të ndryshohet përpara se të hyjë në fuqi ky ligj; përndryshe, kompetencat e Gjykatës (e cila ka dimension kushtetues) nuk do të ishin në harmoni me Kodin e Procedurës Penale.

Neni gjithashtu e ndalon zgjerimin e juridiksionit përtej kompetencave të parashikuara në Nenin 135, paragrafi 2 të Kushtetutës. Strukturat e posaçme kundër krimin duhet të kenë një fokus real dhe mund të humbasin energjinë, burimet dhe përgjegjshmërinë e tyre nëse u kërkohet të bëjnë

shumë gjëra të ndryshme, pa lidhje mes tyre. Neni 135, paragrafi 2 parashikon: “Gjykatat e specializuara janë kompetente për gjykimin e korrupsionit dhe krimin të organizuar, si dhe veprat penale të kryera nga Presidenti i Republikës, Kryetari i Kuvendit, Kryeministri, Anëtarët e Këshillit të Ministrave, gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, si edhe Prokurori i Përgjithshëm, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Kryetari i Bashkisë, anëtarët e Kuvendit, zëvendës ministrat, anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si dhe drejtuesit e institucioneve qendrore apo të pavarura shtetërore, siç parashikohet në Kushtetutë apo në ligj, si dhe akuzat ndaj ish-zyrtarëve të lartpërmendur.” Neni 9 përkufizon termin “drejtuesit e institucioneve qendrore apo të pavarura shtetërore.”

Ky nen sqaron gjithashtu se nëse ndaj një zyrtari, sipas Neni 135, paragrafi 2, apo drejtuesi të institucioneve qendrore apo të pavarura shtetërore nuk ngrihet akuzë apo ai person largohet nga detyra, kompetenca nuk i kthehet gjykatave fillestare.

Neni 11

Kompetenca të tjera

Ky nen u parashikon edhe kompetenca të tjera Gjykatave kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar si dhe Prokurorisë së Posaçme. Një kompetencë dytësore kërkon që Gjykata të ketë kompetencë parësore sipas Neni 10, si për shembull ndaj një veprë korrupsioni. Nëse Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar si dhe Prokuroria e Posaçme e kanë atë kompetencë parësore, ato kanë edhe kompetencë për të hetuar dhe ndjekur penalisht çdo vepër tjetër penale që ka rëndësi dhe është e lidhur ngushtë me hetimin apo çështjen penale. Frazë “vepra penale të lidhura ngushtë me çështjen apo hetimin” përkufizohet tek Neni 9, paragrafi 5. Për shembull, Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar mund të ketë juridiksion për korrupsionin. Kërcënimet ndaj një dëshmitari në atë çështje do të ishin të lidhura ngushtë, dhe si rrjedhojë brenda kompetencave të tjera. Ndërsa një akuzë për vjedhje ndaj të njëjtit të pandehur mund të mos jetë e lidhur ngushtë.

Në mënyrë të ngjashme, Gjykatat kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar si dhe Prokuroria e Posaçme kanë kompetenca edhe për konfiskimin e pasurive të lidhura, nëpërmjet Ligjit për Parandalimin dhe Luftën kundër Krimin të Organizuar, Trafikimit dhe Korrupsionit nëpërmjet Masave Parandaluese ndaj Pasurisë, si dhe Masat për Mbrojtjen e Dëshmitarëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Megjithatë, kjo mund të bëhet vetëm në çështje që bien nën kompetencat parësore, të parashikuara nga Neni 10.

Neni 12

Juridiksioni kombëtar

Ky nen sqaron se Prokuroria e Posaçme ka kompetencë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë për hetimin dhe ndjekjen penale të çdo veprë të parashikuar nga nenet 10 dhe 11. Kjo është kompetencë e Gjykatës dhe nënkuptohet nga marrëdhënia mes Gjykatës dhe Prokurorisë. Megjithatë, nuk është shprehur qartë as në Kushtetutë e as gjetkë në ligj. Si rrjedhojë, ky nen është i nevojshëm.

KREU III PROKURORIA E POSAÇME

Neni 13

Prokuroria e Posaçme

Ky nen përshkruan strukturën e Prokurorisë së Posaçme, e cila përbëhet nga një Drejtues i Prokurorisë dhe nga Prokurorët e Posaçëm. Ajo mund të mbështetet edhe nga departamente të cilët përshkruhen në nene të tjera në këtë ligj. Megjithatë, nëse nuk specifikohet ndryshe në këtë ligj, organizimi dhe veprimtaria e Prokurorisë normohen nga Ligji për Organizimin dhe Funksonimin e Prokurorisë.

Neni 148/dh i projekt-ndryshimeve kushtetuese përshkruan numrin minimal të prokurorëve të posaçëm, i cili është dhjetë. Normalisht mund të ketë më shumë, nëse Këshilli i Lartë i Prokurorisë vendos që Prokuroria duhet të jetë më e madhe. Ishte i nevojshëm një numër minimal, pasi misioni i Prokurorisë mund të vendosej në vështirësi nëse në të do të emëroheshin një numër i pamjaftueshëm prokurorësh. Ky doli si problem në rastin e USKOK në Kroaci në vitet e para, por më pas ju dha personeli dhe fondet e nevojshme. Në të njëjtën mënyrë, Neni 148/dh përshkruan edhe se si Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme zgjidhet nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, si dhe se si mund të emërohet e largohet një prokuror i posaçëm.

Neni 14

Prokurorët e posaçëm të Prokurorisë së Posaçme

Të gjithë prokurorët e Prokurorisë së Posaçme quhen Prokurorë të Posaçëm. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme duhet të vijë nga radhët e këtyre Prokurorëve të Posaçëm. Këshilli i Lartë i Prokurorisë i zgjedh ata në përputhje me Nenin 148/dh të projekt-ndryshimeve të Kushtetutës si dhe Projektligjin për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Ky nen jep edhe përcaktime të tjera në lidhje me kushtet për të qenë Prokuror i Posaçëm, të cilat parashikohen në Nenin 148/dh.

Ky nen parashikon që kandidatët për Prokurorë të Posaçëm të Prokurorisë së Posaçme duhet të përmbushin parakushtet e sigurisë të Nenit 8. Ministria e Drejtësisë rekomandoi që kandidati të mos caktohet me detyrë në Prokurorinë e Posaçme pa përmbushur parakushtet e sigurisë, kushtet e aftësisë profesionale, si dhe parakushtet shëndetësore. Sipas këtij propozimi, kandidatët duhet të ekzaminohen nga një grup ekspertësh mjekoligjorë përpara se të caktohen me detyrë në Prokurorinë e Posaçme. Propozimi përfshinte më tej edhe një vlerësim psikologjik, por vlerësimet psikologjike duhet të normohen me standarde të rrepta, përndryshe rrezikojnë të jenë arbitrare. Ky sugjerim nuk u pasqyrua në draft.

Më tej, një kandidat i cili ka marrë një opinion negativ nga Inspektorati i Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe Konfliktit të Interesave ose nga Autoriteti i Sigurisë Kombëtare nuk mund të caktohet me detyrë në Prokurorinë e Posaçme.

Neni 15

Pavarësia e prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme

Prokuroria e Posaçme ka një shkallë më të lartë pavarësie sesa prokuroritë e tjera. Kjo është pjesë e masave anti-korrupsion, të cilat përdoren edhe në Rumani dhe Kroaci. Në këto dy vende, prokurori i USKOK apo DNA mund të ndjekë (dhe ka ndjekur) penalisht një prokuror tjetër të prokurorisë së tij/saj për korrupsion apo nxjerrje informacioni. Nëse prokurorët janë nën drejtimin e prokurorëve më të lartë, si Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, atëherë ky vetë-normim nuk mund të jetë i mundshëm. E njëjta liri veprimi i jepet edhe një Prokurori të Posaçëm që heton një gjyqtar. Në këtë mënyrë, ky nen siguron që Prokurorët e Posaçëm të jenë të pavarur nga çdo prokuror tjetër, madje edhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme. As Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme nuk lejohet të udhëzojë Prokurorët e Posaçëm për veprime apo mosveprime në lidhje me thelbin e një hetimi apo themelin e ndonjë çështjeje.

Ky nen rritet gjithashtu se edhe Prokurorët të Posaçëm, në mënyrë individuale, dhe jo vetëm Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, mund të drejtojnë veprimet e Byrosë Kombëtare të Hetimit. Pavarësia e një Prokurori të Posaçëm nuk ka kuptim nëse ata nuk mund të drejtojnë një hetim.

Neni 16

Drejtuessi i Prokurorisë së Posaçme

Paragrafi 1 i Nenit 16 thjesht parashikon që Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme zgjidhet në përputhje me Nenin 148/dh, paragrafi 3, të projekt-Kushtetutës. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme zgjidhet nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, nga radhët e Prokurorëve të Posaçëm të cilët janë të emëruar në Prokurori. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme zgjidhet për një mandat tre-vjeçar, pa të drejtë rinovimi. Kjo do të thotë që roli i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme kalohet me rotacion ndërmjet prokurorëve, gjë që është një masë anti-korrupsion dhe anti-korporatizëm. Përndryshe Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme do të bëhej një funksion i pushtetshëm, me pak mundësi kontrolli.

Neni 15 parashikon pavarësinë e Prokurorëve të Posaçëm. Kjo ngre natyrshëm pyetjen: çfarë bën Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme? Kësaj pyetjeje i përgjigjet Neni 16, duke renditur detyrat e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme. Kryesisht ai/ajo administron Prokurorinë e Posaçme, por nuk mbikëqyr hetimet apo ndjekjet penale. Ai/ajo mund të caktojë çështje prokurorëve, dhe mund të bashkërendojë në lidhje me juridiksionin e BKH-së, Policisë së Shtetit dhe institucioneve të tjera. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme jo vetëm që përcakton buxhetin për Prokurorinë e Posaçme dhe BKH-në, por edhe i dorëzon Këshillit të Lartë të Prokurorisë një raport mbi veprimtarinë. Më tej Këshilli i Lartë i Prokurorisë mund ta përfshijë këtë raport në raportin e tij për Kuvendin.

Prokuroria e Posaçme mund të organizojë një mbledhje, gjë që normohet nga Neni 17. Detyrën për thirrjen e këtyre mbledhjeve e ka Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, i cili mund t'i përdorë këto mbledhje për të hartuar udhëzime me shkrim për BKH-në apo për të nxjerrë udhëzime administrative për Prokurorinë e Posaçme.

Kushtetuta nuk krijon një post zëvendësi të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme. Megjithatë, ky ligj mund t'i japë Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme të drejtën për të emëruar një Prokuror të Posaçëm tjetër si Drejtues i Komanduar i Prokurorisë së Posaçme për një periudhë prej jo më shumë se 45 ditësh. Kjo kompetencë mund të përdoret në rastet kur Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme është sëmurë apo i lënduar, ose në rastet kur ai/ajo ka nevojë të mungojë për një periudhë të gjatë kohe.

Neni 17

Mbledhja e Prokurorisë së Posaçme

Ky nen normon ato që mund të diskutohen e vendosen gjatë një mbledhjeje të Prokurorisë së Posaçme. Gjatë një mbledhjeje të tillë, prokurorët e posaçëm mund miratojnë rregulla të brendshme administrative dhe rregullore të nxjerra nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme. Kjo do të thotë që Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme mund të hartojë rregulla e akte normative për prokurorinë, por vetëm me miratimin e një shumice të prokurorëve të tjerë të posaçëm. Gjithashtu, Prokurorët e Posaçëm mund të krijojnë komisione apo të trajtojnë çështje të personelit, disiplinës, sigurisë apo çështje të tjera administrative.

Një risi tjetër e Mbledhjes së Prokurorëve të Posaçëm është të paturit e një kontrolli të brendshëm të pushimit të çështjeve. Prokurorët e Posaçëm janë të pavarur, por kjo pavarësi duhet të kufizohet nga disa kontrole e vëzhgime. Në këtë rast, një Prokuror i Posaçëm mund të vendosë se nuk ka prova të mjaftueshme për të vazhduar një hetim. Për ta pushuar çështjen, ai/ajo duhet të paraqesë arsyet tek Mbledhja e Prokurorisë së Posaçme, në përputhje me Nenin 27 të këtij ligji. Nëse të tjerët bien dakord, atëherë çështja mund të pushohet. Pushimi i paarsyetuar i çështjes është një mënyrë e përhapur korrupsioni, pasi është e lehtë të pretendohet se nuk pati prova të mjaftueshme.

Neni 18

Struktura e Prokurorisë së Posaçme

Ky nen përshkruan strukturën e Prokurorisë, që nuk është vetëm dhjetë prokurorë, por seksionet të cilat normohen nga Nenet 19-25. Punonjësit e çdo seksioni u nënshtrohen kushteve të sigurisë sipas Nenit 8 dhe Kreut VIII të këtij ligji.

Neni 19

Kancelari dhe Seksioni i Dokumentacionit

Ky nen normon Kancelarin dhe Seksionin e Dokumentacionit të Prokurorisë. Kancelari është drejtuesi i administratës, i cili mbikëqyr dosjet, arkivën dhe punët e tjera administrative të Prokurorisë. Kancelari përgjigjet drejtpërsëdrejti tek Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme.

Seksioni i Dokumentacionit është nën varësinë e Kancelarit dhe u krijua mbështetur tek një sugjerim nga USKOK. Seksioni i Dokumentacionit ruan të dhëna mbi veprat penale dhe çështjet e ndjekura nga Prokuroria e Posaçme, dhe mund të përdoret për të raportuar mbi prirjet e çështjeve penale në kompetencë të kësaj Prokurorie.

Neni 20

Seksioni i Ekspertizës

SPAK ka për qëllim hetimin dhe ndjekjen penale të çështjeve të vështira apo të ndërlikuara. Të paturit e njohurive eksperte brenda Prokurorisë mund të rrisë dukshëm aftësinë për të analizuar

prova dhe ndihmuar prokurorët dhe BKH-në. Ekspertët duhet të kenë arsim të avancuar në fushën e tyre dhe të paktën pesë vite përvojë. Prokuroria duhet të ketë minimalisht një ekspert kontabël dhe një ekspert të teknologjisë së informacionit. Kjo do të bënte që Prokuroria të ishte në gjendje të analizonte të dhëna bankare, dokumente financiare, të gjurmonte paratë e pastruara apo provat elektronike. Këto janë instrumente kyçe për një prokurori moderne që heton korrupsionin apo krimin e organizuar. Gjithashtu, nëse BKH-ja ka ekspertë, ata nuk përjashtohen nga mundësia për të ndihmuar, por nxiten nëpërmjet paragrafit 3 të ndihmojnë Seksionin e Ekspertizës së Prokurorisë së Posaçme.

Neni 21

Seksioni i Hetimit Financiar

SPAK ka për qëllim hetimin dhe ndjekjen penale të çështjeve me korrupsion e krim të organizuar, apo çështjeve ku përfshihen të pandehur me pushtet. Shpesh hasen pasuri të cilat duhet të identifikohen e konfiskohen. Të paturit e një seksioni të tillë në Prokurori mund të rrisë dukshëm aftësinë për të identifikuar pasuri a prona dhe për të ndihmuar prokurorët e posaçëm t'i konfiskojnë ato.

Kualifikimet e nevojshme për këtë pozicion janë një diplomë në drejtësi, financë, kontabilitet apo në fusha të tjera përkatëse. Pas sugjerimit të Ministrisë së Drejtësisë u shtua një kualifikim tjetër, që është të paktën dy vite përvojë si oficer i policisë gjyqësore.

Neni 22

Ndërlidhësi për bashkëpunimin ndërkombëtar dhe hetimet e përbashkëta

SPAK ka për qëllim hetimin dhe ndjekjen penale të çështjeve të vështira apo të ndërlikuara, dhe shpeshherë provat, dëshmitarët apo të pandehurit do të jenë jashtë Shqipërisë. SPAK duhet të ketë një person i cili të mund të lehtësojë bashkëpunimin ndërkombëtar. Në fakt, kjo lehtëson hetimet në pjesën më të madhe të sistemeve moderne të ndjekjeve penale. Meqë SPAK është i pavarur nga Prokurori i Përgjithshëm, asaj i duhet një pozicion i ngjashëm. Për më tepër, ky pozicion mund të shërbejë si ndërlidhës për hetimet e përbashkëta me shtete të tjera. Ekipet e Përbashkëta Hetimore (EPH) janë të përhapura dhe nxiten nga konventat ndërkombëtare. Për shembull, Neni 13 i Konventës së Bashkimit Evropian për Ndihmën e Ndërsjellë Ligjore i autorizon vendet e BE-së të krijojnë EPH. Edhe shtetet jo-anëtare të BE-së janë të lejuara të marrin pjesë në këto ekipe. Edhe jashtë BE-së, Neni 19 i Konventës së OKB-së kundër Krimin të Organizuar Transnacional (“Konventa e Palermos”) i nxit shtetet nënshkruese të marrin masa për hetime të përbashkëta. Shqipëria e ka ratifikuar Konventën e Palermos më 21 gusht 2002.

Ndërlidhësi duhet të ketë minimalisht arsim të lartë në drejtësi dhe një diplomë masteri, nga të cilat njëra duhet të jetë marrë jashtë Shqipërisë. Kjo dispozitë ka për qëllim të garantojë që personi të ketë njohuri të mjaftueshme nga sisteme të tjera ligjore. Në këtë pozicion mund të atashohet edhe një prokuror i cili i përmbush kriteret. Kandidati duhet të ketë të paktën pesë vite përvojë, çka të jep gjykimin e duhur për të punuar me vende të tjera. Për shkak të natyrës së këtij

pozicioni, ndërlidhësi duhet të flasë rrjedhshëm gjuhën shqipe dhe atë angleze, si dhe duhet të njohë një gjuhë tjetër të huaj.

Neni 23

Detyrat e ndërlidhësit

Ky nen rendit detyrat e ndërlidhësit, i cili duhet të respektojë marrëveshjet ndërkombëtare gjatë bashkëpunimit me shtete të tjera apo organizata ndërkombëtare. Për shembull, ndër këto organizata mund të përmendim EUROPOL apo INTERPOL, ose një organ të Kombeve të Bashkuara. Ndërlidhësi duhet të jetë në gjendje të drejtojë bashkëpunimin në fushën ndërkombëtare, por edhe të caktojë të tjerë të kryejnë një pjesë të një hetimi të përbashkët. Hetimet e përbashkëta mund të kërkojnë që edhe SPAK të hetojë në emër të vendeve të tjera, sidomos nëse veprat penale kryhen në disa vende. Ligji parashikon që këto hetime të bien në kompetencat e parashtruara në Nenin 75/a. Kjo përputhet me parimin ndërkombëtar të kriminalitetit të dyfishtë. Nëse një çështje në hetim të përbashkët nuk mund të zgjidhet duke u konsultuar me organet e tjera kompetente, Ndërlidhësi informon Drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme, i cili më pas i kërkon një Ministrie kompetente të ndihmojë apo të japë një mendim.

Neni parashikon që Ndërlidhësi të kryejë edhe veprime urgjente, dhe që mund të përfshijë zyrtarë nga shtete të tjera. Ndërlidhësi vepron në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe të drejtën ndërkombëtare, por do të mbikëqyrte veprimet e këtyre zyrtarëve dhe do t'i dorëzonte një raport Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme.

Neni 24

Koordinatori për Marrëdhënien me Mediat

Në shumë prokurori moderne të cilat merren me çështje tepër të rënda, ekziston një mirëkuptim që vetë prokurorët duhet të flasin rrallë me mediat. Nxjerrja e informacionit në media është dëmuese për hetimet penale të ndjeshme. Prokuroria e Posaçme do të ketë një Koordinator për Marrëdhëniet me Mediat, i cili vepron si ndërlidhës mes Prokurorisë dhe mediave vendase e ndërkombëtare. Ky koordinator është i vetmi person i autorizuar për të folur me mediat në emër të Prokurorisë në lidhje me hetime apo çështje. Ky person duhet të ketë të paktën pesë vite përvojë pune me një organizatë mediatike apo si ndërlidhës shtypi i një agjencie publike, organizate ndërkombëtare apo ambasade. Arsimi i tij është i një fushe që ka lidhje me detyrën, dhe duhet të jetë në gjendje të komunikojë në shqip por edhe në anglisht, pasi shumë gazetarë të huaj mund të telefonojnë për të marrë informacion në lidhje me çështje të bujshme.

Koordinatori për Marrëdhëniet me Mediat ka rol edhe në publikimin e çështjeve si korrupsioni, dhe në mënyrat e raportimit të tij tek SPAK apo BKH. Koordinatori është edhe zëdhënës. Me autorizim të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, Koordinatori mund të informojë publikun mbi punën e Prokurorisë.

Neni 25

Seksioni për Asistencën për Individët me Status të Posaçëm

Ky nen është harmonizuar për të qenë në përputhje me projekt-Ligjin për Prokurorinë. Në Evropë dhe Amerikë është standarde që prokuroritë të kenë koordinatorë për të drejtat e viktimave. Në projektligjin për Prokurorinë, prokuroritë duhet tu japin asistencë personave me Status të Posaçëm, ku përfshihen të miturit, dëshmitarët dhe viktimat. Në rastin e SPAK, do të përfshiheshin pothuajse gjithmonë viktimat e krimeve dhe dëshmitarët. Qëllimi është tu ofrohen viktimave dhe dëshmitarëve të krimit shërbimet e nevojshme, por edhe të ndihmohen të njohin të drejtat e tyre dhe të kuptojnë çfarë po ndodh në çështjen e tyre. Shpesh një viktimë apo dëshmitar i cili i njih të drejtat dhe është i informuar mbi atë që po ndodh, është më bashkëpunues me prokurorët. Seksioni do të ketë të paktën dy Koordinatorë, por edhe më shumë nëse nevojitet për shkak të numrit të hetimeve dhe çështjeve. Koordinatorët duhet të kenë një diplomë në një fushë përkatëse, si për shembull në psikologji apo sociologji. Tani në disa universitete në BE ofrohen edhe studime në Viktimologji, e cila është një nën-degë e sociologjisë apo kriminologjisë.

Neni 26

Mbikëqyrja e punonjësve dhe ekspertëve

Është shumë e rëndësishme që një prokurori të ketë strukturën administrative dhe autoritetin që i mundëson të punojë lirshëm, por duhet të sigurohet edhe që caktimi i burimeve dhe personelit të mos përdoret për të cënuar pavarësinë e ndonjë prokurori në hetimet apo ndjekjet penale të tij/saj. Ky nen përcakton ndarjen e përgjegjësisë brenda prokurorisë, si dhe u jep të drejtën Prokurorëve të Posaçëm të mbikëqyrin personelin e tyre dhe ekspertët e caktuar në hetime. Megjithatë, ekspertëve nuk mund tu thuhet çfarë mendimi të japin. Standardi ndërkombëtar për ekspertët është që ata të japin mendimet e tyre bazuar në prova, fakte, ekspertizë (ku përfshihen njohuritë e hulumtimeve shkencore në atë fushë të caktuar) si dhe rezultatet e analizave.

Neni 27

Pushimi i çështjeve ose akuzave nga prokurori i posaçëm

As Kodi aktual i Procedurës Penale i Shqipërisë, dhe as ndryshimet e propozuara për të, nuk lejojnë që hetimi apo ndjekja penale e çështjeve të jetë nën kontrollin e një gjyqtari. Prokuroria ka të drejtën e vendimmarrjes për pushimin e një hetimi, me pëlqimin e një eprori, sipas Kodit aktual. Në strukturën aktuale të Prokurorisë së Posaçme, Drejtuesi i saj nuk e ka këtë autoritet mbi prokurorë të tjerë të posaçëm. Një prokuror i posaçëm i cili kërkon të pushojë akuzat apo çështjen është i detyruar të kërkojë miratimin e pjesës më të madhe të prokurorëve të posaçëm në mbledhjen e tyre. Një prokuror tjetër i posaçëm merr dosjen në shqyrtim për një periudhë deri në pesëmbëdhjetë ditë, dhe pastaj i raporton mbledhjes së prokurorëve të posaçëm. Ky Prokuror i Posaçëm raporton nëse vendimi i pushimit është i bazuar apo jo, dhe pas këtij relacioni kryhet një votim për të lejuar pushimin e çështjes apo jo. Nëse kërkesa rrëzohet, Prokurori i Posaçëm i asaj çështjeje mund të zëvendësohet në përputhje me Nenin 50 të Ligjit për Prokurorinë.

Neni 28

Apelimet

Prokuroria e Posaçme ndryshon shumë nga prokuroritë e tjera, pasi nuk ka një prokurori të veçantë pranë çdo niveli apeli. Nuk do të ketë një Prokurori të Posaçme Apeli, dhe Prokurori i Përgjithshëm nuk i përfaqëson këto ndjekje penale përpara Gjykatës së Lartë. Pra, ka vetëm një Prokurori të Posaçme. Ka vetëm një Drejtues Prokurorie të Posaçme, dhe jo dy apo tre. Prokurorët e emëruar në Prokurorinë e Posaçme janë me përvojë dhe duhet të jenë të motivuar t'i përfaqësojnë çështjet me sukses në çdo nivel. Në fakt, ky është një aspekt tjetër i pavarësisë së çdo prokurori, i cili nuk kufizohet nga gatishmëria apo motivimi i një prokurori apeli për ta përfaqësuar çështjen në mënyrën më të mirë të mundshme. Prokurorë të tjerë të Posaçëm të Prokurorisë së Posaçme, ose, me kërkesë të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, edhe prokurorë nga Prokuroria e Përgjithshme, mund të ndihmojnë Prokurorët e Posaçëm të përgatiten për mbrojtjen e çështjeve në apel, kur të jetë e nevojshme.

KREU IV

BASHKËPUNIMI ME ORGANET E TJERA

Neni 29

Detyrimet e autoriteteve të tjerë shtetërorë

SPAK është një institucion i cili duhet të bashkëpunojë me organe të tjera, si Policia e Shtetit, autoritetet tatimore, policia kufitare, etj. Ky nen i vendos një detyrim këtyre organeve të raportojnë mbi rrethana dhe të dhëna të cilat janë tregues të një vepre penale në përputhje me Nenin 75/a të Kodit të Procedurës Penale. Këto organe i raportojnë këto rrethana tek BKH-ja apo Prokuroria e Posaçme në mënyrë të menjëhershme. Gjithashtu, këto organe kanë edhe detyrimin të bashkëpunojnë me Prokurorinë e Posaçme dhe me BKH-në gjatë hetimeve.

Në Prokurori të tjera të Posaçme, si USKOK në Kroaci, prokuroria ka akses të drejtpërdrejtë në shumë baza të dhënash dhe shërbime informacioni, çka e lejon të hetojë më shpejt e më me efektivitet. Ky nen i vendos një detyrim autoriteteve shtetërore t'i japin Prokurorisë së Posaçme dhe BKH-së akses të drejtpërdrejtë në bazat e tyre të të dhënave. Autoriteti shtetëror duhet të japë informacion brenda 24 orëve në ato raste kur nuk ka një bazë të dhënash. Nëse baza e të dhënave ekziston, autoriteti duhet t'i krijojë Prokurorisë së Posaçme akses të drejtpërdrejtë. Prokuroria e Posaçme bën kërkesën për akses në bazën e të dhënave dhe brenda gjashtë muajve duhet të jetë bërë lidhja. Ky detyrim nuk ekziston për ato baza të dhënash apo sisteme informacioni të cilat janë çertifikuar për mbajtje sekretesh shtetërore.

Neni 30

Detyrimet e Policisë së Shtetit

SPAK është një institucion i cili duhet të bashkëpunojë me organe të tjera, si Policia e Shtetit. Ky nen detyron punonjësit e Policisë së Shtetit të raportojnë mbi rrethana dhe të dhëna të cilat janë tregues të një veprë penale në përputhje me Nenin 75/a të Kodit të Procedurës Penale. Këto organe i raportojnë këto rrethana tek Byroja Kombëtare e Hetimit. Drejtori i BKH-së nxjerr një rregullore e cila përcakton metodën që duhet të ndjekin punonjësit e Policisë së Shtetit për të informuar BKH-në.

Ky nen përcakton më tej metodën me anë të së cilës Prokuroria e Posaçme ose fillon punën mbi atë çështje, ose vendos që ajo nuk është brenda kompetencave të saj, nëse informacioni nuk tregon se është kryer një veprë penale brenda kompetencave të saj, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme informon prokurorinë kompetente që institucioni i tij nuk merr përgjegjësi në lidhje me atë çështje.

Prokuroria e Posaçme është një prokurori që mund të punojë me BKH-në por edhe me Policinë e Shtetit. Në fakt, disa prej çështjeve të saj mund të kenë më shumë lidhje me Policinë e Shtetit, si psh një çështje e krimit të organizuar ku përfshihen edhe lëndë narkotike. Disa veprime, si kontrolle apo arrestime në shkallë të gjerë, apo veprime të cilat paraqesin nevojën e përdorimit të forcave taktike policore, mund të kërkojnë një bashkëpunim të ngushtë mes Policisë së Shtetit dhe Prokurorisë së Posaçme apo BKH-së. Si rrjedhojë, Policia e Shtetit duhet të jetë përgjegjëse edhe për ndjekjen e urdhërave apo kërkesave nga Prokurorë të Posaçëm apo nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme.

Neni 31

Detyrimet e Drejtorisë së Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave

SPAK është një institucion i cili duhet të bashkëpunojë me organe të tjera, si Drejtoria e Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave. Ky nen detyron këtë organ të raportojë mbi instrumente, të ardhura apo asete për të cilat ka marrë dijeni, nëse ka gjasa që ato të jenë përfituar nëpërmjet një veprë penale të parashikuar nga Neni 75/a i Kodit të Procedurës Penale. Gjithashtu e detyron këtë organ të kërkojë informacion mbi këto transaksione nga subjektet e detyruara për të zbatuar masa kundër pastrimit të parave, si bankat, dhe t'ia dërgojë menjëherë këtë informacion Prokurorisë së Posaçme. Ky nen parashikon një sërë detyrash të cilat duhet të krijojnë një marrëdhënie pune mes SPAK dhe Drejtorisë së Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave për të identifikuar asetet dhe transaksionet që rrjedhin nga vepra penale të parashikuara nga Neni 75/a i Kodit të Procedurës Penale, si dhe për të ekzekutuar vendime për sekuestrimin e konfiskimin e këtyre aseteve.

KREU V BYROJA KOMBËTARE E HETIMIT

Neni 32

Byroja Kombëtare e Hetimit

SPAK përbëhet nga Prokuroria e Posaçme dhe një organ i pavarur nën drejtimin e saj, i cili kryen hetime. Ky organ është i pavarur nga strukturat normale policore, dhe është një seksion i specializuar i Policisë Gjyqësore që vepron në përputhje me *lex specialis*. Në Prokurorinë e Posaçme, të gjitha strukturat policore duhet t'i përgjigjen asaj siç do të bënin me çdo prokuror. Megjithatë, Byroja Kombëtare e Hetimit është një organ i posaçëm, i pavarur, i cili kryen hetime vetëm për Prokurorinë e Posaçme, dhe është larg çdo ndikimi të jashtëm. BKH-ja fillimisht u parashikua si një organ për të kryer hetime vetëm kundër zyrtarëve të lartë dhe për çështje korrupsioni, dhe ka gjasa që kjo të jetë kompetenca e saj bazë. Disa hetime të krimit të organizuar ka më shumë gjasa të përfshijnë Policinë e Shtetit në mënyra të ndryshme, pasi ajo ka më shumë burime dhe mund të mbajë një rrjet më të gjerë informatorësh. Në këtë mënyrë, Byroja Kombëtare e Hetimit duhet të ketë rrjetin e saj të agjentëve të verifikuar e monitoruar, si dhe një mënyrë bashkëpunimi me Policinë e Shtetit.

Si rrjedhojë, BKH-ja ka një strukturë me një Drejtor dhe një grup bërthamë hetuesish të cilët varen vetëm nga Prokuroria e Posaçme. Drejtori dhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme mund të kryejnë sëbashku organizimin e brendshëm të BKH-së, i cili ka për qëllim tu japë fleksibilitetin e duhur për përballimin e nevojave në ndryshim për hetimin e këtyre çështjeve të vështira. Megjithatë, BKH-ja ka edhe një Zëvendës Drejtor, detyra kryesore e të cilit është mbikëqyrja e Shërbimeve të Policisë Gjyqësore të Byrosë Kombëtare të Hetimit. Ato përbëhen nga punonjës të policisë gjyqësore të Policisë së Shtetit dhe të institucioneve të tjera përkatëse, nën drejtimin administrativ të Zëvendës Drejtorit.

Ky nen sigurohet edhe që buxheti i BKH-së të përfshihet në buxhetin e Prokurorisë së Posaçme.

Neni 33

Punonjësit e Byrosë Kombëtare të Hetimit

Ky nen parashikon që punonjësit e BKH-së, përfshirë drejtorin, zëvendës drejtorin, hetuesit, punonjësit dhe personat pranë shërbimeve të policisë gjyqësore, duhet të përmbushin kushtet e sigurisë të përcaktuara në këtë ligj, përfshirë verifikimin e personalitetit dhe heqjen dorë nga e drejta për privatësi në telekomunikime dhe llogari financiare, të firmosur nga kandidati dhe anëtarët e afërt të familjes. Për më tepër, ky nen parashikon që Drejtori, Zëvendës Drejtori apo Hetuesi i Byrosë Kombëtare të Hetimit duhet të kenë përfunduar një program trajnimi të miratuar nga Komisioni i Pavarur i Rishikimit. Kandidatët për oficerë të shërbimeve të policisë gjyqësore duhet të respektojnë parashikimet e paragrafit 1 dhe brenda dy muajve nga emërimi duhet të kenë përfunduar një program trajnimi të miratuar nga Komisioni i Pavarur i Rishikimit, në përputhje me Nenin 46.

Neni 34

Drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit

Drejtori është përgjegjës për funksionimin e Byrosë Kombëtare të Hetimit. Ky nen përcakton procesin për përzgjedhjen e Drejtorit të BKH-së, si dhe kushtet për mbikëqyrjen e tij/saj. Pas një procesi rekrutimi të hapur dhe transparent, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme dhe dy prokurorë të posaçëm të tjerë me më shumë vite përvojë pune, rekomandojnë një kandidat për drejtor. Ai/ajo emërohet nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë për një mandat 5 vjeçar, me të drejtë riemërimi një herë. Drejtori mbikëqyret nga një komision i përbërë prej tre prokurorësh të Prokurorisë së Posaçme, njëri prej të cilëve është drejtuesi i saj dhe dy të tjerët zgjidhen çdo vit me short. Ky organizim ka për qëllim të sigurojë një mbikëqyrje të fortë nga Prokuroria e Posaçme. Drejtori nuk duhet të jetë i pakontrollueshëm, por duhet t'i raportojë Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme. Megjithatë, në këtë mekanizëm mbikëqyrjeje përfshihen edhe dy prokurorë të posaçëm të tjerë, pasi kjo zvogëlon mundësinë e sjelljes korporatiste.

Drejtori ka kompetencë edhe të emërojë një prej hetuesve në postin e zëvendës drejtorit, por me pëlqimin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme. Zëvendës Drejtori mund të veprojë në emër të Drejtorit, në mungesë të tij, por roli i tij kryesor mbetet mbikëqyrja e Shërbimeve të Policisë Gjyqësore.

Neni 35

Emërimi i Drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit

Ky nen parashikon procedura dhe kushte më të hollësishme për emërimin e Drejtorit. Drejtori mund të vijë nga radhët e Policisë së Shtetit, Policisë Gjyqësore, ose hetueve të Byrosë Kombëtare të Hetimit. Gjithashtu kandidat mund të jetë edhe një prokuror i cili përmbush kërkesat e paragrafit 3, ku renditen kriteret.

Kandidati për t'u emëruar si drejtor duhet të ketë reputacion të njohur si person me integritet dhe i njohur për një punë me standardet më të larta profesionale. Drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit duhet të ketë të njëjtat kualifikime për të qenë hetues i Byrosë Kombëtare të Hetimit ku përfshihet detyrimi për të kryer kursin e miratuar të trajnimit përpara se të fillojë detyrën. Sigurisht që edhe hetuesit e BKH-së, të cilët gjithashtu duhet të kryejnë këtë trajnim, do të ishin të kualifikuar. Megjithatë, të kualifikuar mund të jenë edhe të tjerë, dhe ata mund të emërohen pasi të kenë kryer trajnimin.

Kandidati për postin e drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit duhet të ketë nënshtetësinë shqiptare dhe arsim policor, juridik apo ekonomik. Nëse kandidati është punonjës i Policisë së Shtetit, ai/ajo duhet të mbajë gradën “Drejtues i Parë” ose “Drejtues”. Kandidati do të drejtojë një njësi hetimore që do të kryejë hetime të ndërlikuara, e si rrjedhojë duhet të ketë përvojë si dhe të ketë patur poste drejtuese. Kandidatët duhet të kenë përvojë të paktën shtatë vjeçare në hetimin e veprave penale në fushën e korrupsionit, krimin të organizuar apo krimeve të rënda. Kandidati duhet të demonstrojë aftësi të larta profesionale dhe cilësi të larta morale, si dhe të mos jetë nën efektet e një mase disiplinore, ose të jetë nën hetim apo gjykim për një veprë penale. Kandidati duhet të mos ketë qenë i dënuar për kryerjen e një veprë penale në Shqipëri apo vende të tjera, në përputhje me Ligjin për Dekriminalizimin. Së fundmi, kandidati duhet të ketë kaluar me sukses testin e poligrafit për integritetin dhe motivimin. Disa prej këtyre

kërkesave janë mbështetur në kërkesat përkatëse për tu bërë agjent i Byrosë Federale të Hetimit të SHBA.

Neni 36

Lirimi/shkarkimi nga detyra i Drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit

Ky nen parashtrohet kushtet për lirimin nga detyra të Drejtorit nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Nëse Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme rekomandon që Drejtori të shkarkohet për shkak të një vendimi gjyqësor, shkelje të rëndë të disiplinës, apo për shkak se dalin fakte që tregojnë se ai/ajo nuk i përmbush kriteret për atë detyrë, Këshilli i Lartë i Prokurorisë mund ta shkarkojë Drejtorin. Po ashtu, Drejtori mund të pezullohet nga Këshilli nëse bëhet subjekti i një hetimi penal.

Neni 37

Zëvendës Drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit

Zëvendës Drejtori emërohet nga Drejtori dhe nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, bashkarisht. Ai/ajo është përgjegjës për funksionimin e Shërbimeve të Policisë Gjyqësore të BKH-së dhe për funksionimin e pandërprerë të BKH-së edhe gjatë mungesës së Drejtorit.

Zëvendës Drejtori përzgjidhet nga hetuesit e BKH-së, dhe nuk mund të vijë nga jashtë BKH-së. Ai/ajo duhet të ketë të paktën 3 vjet përvojë pune në hetimin e veprave penale të korrupsionit, krimit të organizuar apo krimeve të rënda, si dhe duhet të ketë treguar aftësi të drejtimit të disa punonjësve. Zëvendës Drejtori ka mandat 4 vjeçar e mund të shërbejë maksimumi 8 vite. Në përfundim të mandatit, ai/ajo kthehet në postin e hetuesit të BKH-së.

Zëvendës Drejtori raporton tek Drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit, por nuk mund të shkarkohet nga ky i fundit. Ai mund të shkarkohet apo pezullohet nga detyra vetëm nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, për shkaqe të ngjashme me ato për shkarkimin e Drejtorit.

Neni 38

Hetuesi i Byrosë Kombëtare të Hetimit

Ky nen përcakton detyrat dhe kualifikimet e hetuesve të BKH-së. Hetuesit kryejnë hetime nën drejtimin e prokurorëve të posaçëm. Ata përzgjidhen pas një procesi rekrutimi dhe aplikimi të hapur e transparent. Një person mund të emërohet si hetues i Byrosë Kombëtare të Hetimit vetëm pasi të ketë përfunduar trajnimin e kërkuar dhe të ketë shfaqur aftësitë për kryerjen e detyrave sipas standardeve të kërkuara profesionale. Kriteret specifike renditen në Nenin 39.

Pasi përzgjidhet dhe përfundon hetimin, hetuesit emërohen si hetues nga drejtori, me pëlqimin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme. Ata mund të caktohen nga Drejtori apo Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme të punojnë me një prokuror të posaçëm të caktuar, por Drejtori nuk mund t'i caktojë në një detyrë tjetër pa pëlqimin e prokurorit të posaçëm ose të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme.

Neni 39

Kriteret për emërimin dhe largimin e hetuesit të Byrosë Kombëtare të Hetimit

Ky nen përcakton kriteret specifike për emërimin dhe largimin e hetuesit të Byrosë Kombëtare të Hetimit. Ai/ajo duhet të ketë nënshtetësinë shqiptare dhe arsim policor, juridik apo kontabilitet, ose një diplomë në një fushë të ngjashme. Hetuesi i BKH-së duhet të ketë përvojë të paktën 1 vjeçare në fushën e zbatimit të ligjit ose fusha të ngjashme me të. E rëndësishme është edhe që kandidati duhet të përmbushë me sukses kriteret e përzgjedhjes dhe trajnimit të Byrosë Kombëtare të Hetimit. Në këtë nen përcaktohet një proces i hollësishëm për intervistimin dhe testimin e kandidatëve, i cili mbështetet tek procesi i rekrutimit i Byrosë Federale të Hetimit të SHBA dhe ka për synim të jetë transparent dhe i hapur. Kursi i trajnimit do të jetë rigoroz dhe sipas standardeve ndërkombëtare. Kurrikula e kursit miratohet nga Drejtori, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme dhe nga Bordi i Pavarur i Rishikimit.

Neni 40

Shërbimet e Policisë Gjyqësore të Byrosë Kombëtare të Hetimit

Ky nen krijon dhe normon Shërbimet e Policisë Gjyqësore të BKH-së. Në mënyrë që të rritet bashkëpunimi dhe komunikimi i informacionit mes BKH-së dhe institucioneve të tjera, grupi i punës dhe ekspertët e konsideruan të rëndësishëm krijimin e një mekanizmi për lehtësimin e hetimeve të Prokurorisë së Posaçme që kryhen nga institucionet e tjera, si dhe shtimin e burimeve njerëzore të SPAK. Shërbimet e policisë gjyqësore drejtohen nga Zëvendës Drejtori i BKH-së.

Shërbimet e Policisë Gjyqësore atashohen nga institucionet e tyre për 5 vjet. Ata duhet të kenë pranuar monitorimin e telekomunikimeve si dhe të llogarive financiare të tyre. Në mënyrë që BKH dhe Prokuroria e Posaçme të ruajnë përgjegjshmërinë e këtyre oficerëve të policisë gjyqësore, këta të fundit do të paguhën nga BKH-ja, do të raportojnë tek Zëvendës Drejtori dhe do të vlerësohen nga Zëvendës Drejtori. Në përfundim të mandatit të tyre, Zëvendës Drejtori dërgon vlerësimet tek institucioni prej të cilit ka ardhur Oficeri i Policisë Gjyqësore.

Pjesa më e madhe e policisë gjyqësore do të vijë nga radhët e Policisë së Shtetit. Drejtori i Policisë së Shtetit do të hartojë rregullore të përbashkët me Drejtorin e Byrosë Kombëtare të Hetimit për caktimin e individëve të kualifikuar për të shërbyer në Shërbimet e Policisë Gjyqësore. Ky nen normon mënyrën si Policia e Shtetit do të njoftojë publikisht për procesin e aplikimit. Në mënyrë të ngjashme, edhe institucionet e tjera me funksione të policisë gjyqësore do të hartojnë rregullore të përbashkëta me Drejtorin e Byrosë Kombëtare të Hetimit.

Ligji i siguron fleksibilitet BKH-së, në mënyrë që të sigurohet që mund të kryejë hetime sa më efikase. Si rrjedhojë, Shërbimet e Policisë Gjyqësore mund të punojnë në zyrat nga ku ata kanë ardhur ose në zyrat e Byrosë Kombëtare të Hetimit. Këtë e vendos Drejtori. Për më tepër, Drejtori ose një Prokuror i Posaçëm mund të caktojnë hetues nga zyra e saj të vendosen pranë Policisë së Shtetit ose institucioneve të tjera. Policia e Shtetit ose institucionet e tjera marrin

përsipër ta zbatojnë këtë vendim. Kjo i jep mundësinë BKH-së të ketë njohuri të plota mbi veprimet dhe hetimet e institucioneve të tjera teksa kryen hetime.

Neni 41

Statusi i policisë gjyqësore

Ky nen parashikon përcaktimin me anë të *lex specialis* të statusit të drejtorit, zëvendës drejtorit, hetuesve të BKH-së dhe oficerëve të shërbimeve të policisë gjyqësore. Këta zyrtarë janë polici gjyqësore, por nuk janë nën kontrollin e Prokurorit të Përgjithshëm, të Ministrisë apo të ndonjë organi tjetër përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike. Me statusin e tyre si Oficerë të Policisë Gjyqësore, ata janë vetëm nën kontrollin e Prokurorëve të Posaçëm. Për më tepër, ata nuk kanë nevojë të mbështeten në hierarkinë e policisë gjyqësore kur punojnë me prokurorët, por duhet të punojnë e komunikojnë drejtpërsëdrejti me Prokurorët e Posaçëm.

Neni 42

Largimi i punonjësve të Byrosë Kombëtare të Hetimit

Trajnimi dhe verifikimi i punonjësve të BKH-së është i konsiderueshëm dhe në të mund të përfshihen investime të ofruesve të asistencës ndërkombëtare. Si rrjedhojë, hetuesit duhet të angazhohen të shërbejnë në BKH për të paktën 7 vite. Gjithsesi, punonjësi mund të shkarkohet. Shkarkimi kryhet nga Drejtori, me pëlqimin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme dhe pas konsultimit me Komisionin e Pavarur të Rishikimit. Shkarkimi kryhet nëse punonjësi është dënuar për një vepër penale nga një gjykatë penale në Shqipëri apo në ndonjë vend tjetër, nëse punonjësi është vlerësuar nga një panel mjekësh ekspertë si i paaftë nga ana shëndetësore, nëse është kryer një procedurë disiplinore për sjellje jo- profesionale në më shumë se tre raste, ose nëse dalin fakte të reja, të panjohura më parë, të cilat kanë lidhje dhe janë në mospërputhje me kriteret për emërimin e tij/saj.

Neni 43

Oficeri Përgjegjës për Mbikqyrjen

Gjykatat për Anti-Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Prokuroria e Posaçme dhe BKH-ja i nënshtrohen mbikëqyrjes periodike të telekomunikimeve dhe financave. Këto kushte ekzistojnë edhe për prokurori të tjera të posaçme të suksesshme, si USKOK (Kroaci) dhe DNA (Rumani). Mbikëqyrja e telekomunikimeve në këtë rast do të kryhet nga BKH, ndërsa mbikëqyrja financiare nga Njësia e Inteligjencës Financiare.

Përgjegjës për këtë mbikëqyrje do të jetë një hetues i BKH-së. Tek e fundit, këta të gjithë janë vetë persona të verifikuar dhe të mbikëqyrur. Hetuesi, me të paktën pesë vite përvojë, emërohet me short për të shërbyer gjatë një mandati dy vjeçar, pa rinovim të menjëhershëm, si Oficeri Përgjegjës për Mbikqyrjen. Përzgjedhja bëhet me anë të shortit, nga Drejtori, në prani të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme si dhe Kryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë për Anti-Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Oficeri Përgjegjës nuk ka përgjegjësi të tjera hetimore apo administrative, por do të ketë detyrë vetëm mbikëqyrjen, duke përdorur një kalendar pune të rastësishëm. Oficeri Përgjegjës raporton çdo informacion që ngre dyshime të arsyeshme për veprimtari korruptive apo kriminale. Ai/ajo informon një prokuror çfarëdo të posaçëm i cili nuk është i përfshirë në veprimtarinë e dyshimtë. Kjo përbën shkak që ai Prokuror i Posaçëm ta ndjekë këtë çështje me një hetim. Ai/ajo informon Inspektorin e Lartë të Drejtësisë mbi çdo shkelje të etikës.

The Responsible Officer shall have no other investigative or administrative responsibilities, but shall only be there to monitor based on a random schedule. The Responsible Officer reports any communications that give a reasonable suspicion of corrupt or criminal activity. He or she informs any Special Prosecutor who is not involved, and this gives rise to that Special Prosecutor following on with an investigation. He or she informs any ethical misconduct to the High Inspector of Justice.

Oficeri Përgjegjës ruan regjistra të telekomunikimeve në përputhje me ligjin, një urdhër të një prokurori apo gjykatë, si dhe me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Neni 44

Pagat dhe buxheti i Byrosë Kombëtare të Hetimit

Ky nen normon pagat, shtesat e pagave dhe buxhetin e BKH-së. Pagat dhe shtesat e pagave përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, por nuk mund të ulen. Kjo ka për qëllim që të ndalojë qeverinë, e cila mund të jetë subjekt i një hetimi, të ulë pagat si hakmarrje apo kërcënim. Buxheti hartohet nga Drejtori dhe i dorëzohet Ministrit të Financave si buxhet i përbashkët nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme.

Nëse Këshilli i Ministrave krijon një fond të posaçëm për BKH-në, mundësisht nga asetet e konfiskuara, deri në 20% e këtij fondi të posaçëm mund të përdoret për pajisje për BKH-në. Dispozita për fondin e posaçëm u propozua fillimisht në versionin e parë të projekt-ligjit i cili do ta kishte krijuar BKH-në nga Ministria e Brendshme.

Neni 45

Marrëdhëniet e Byrosë Kombëtare të Hetimit me struktura të tjera policore

Ky nen i jep Drejtorit të BKH-së kompetencën të arrijë marrëveshje me institucione të tjera me funksione policore, të cilat mund të ndihmojnë për efikasitetin, kapacitetet apo shkëmbimin e informacionit. Ky nen gjithashtu detyron Policinë e Shtetit dhe institucionet e tjera të bashkëpunojnë me të gjitha kërkesat e ligjshme të ardhura nga hetuesit e BKH-së.

BKH do të ketë akses edhe në bazat e të dhënave me interes të institucioneve të tjera, si dhe do të ketë kapacitetin e pavarur për të ekzekutuar urdhëra përgjimi të kërkuara nga Prokuroria e Posaçme e të lëshuara nga një gjykatë. Oficeri Përgjegjës duhet të kryejë edhe mbikëqyrjen e gjyqtarëve, prokurorëve dhe personave të tjerë në përputhje me Nenin 43, me pëlqimin e tyre, si

pjesë e mbikëqyrjes periodike të telekomunikimeve të tyre. Kjo kërkon edhe një ndryshim të Ligjit për Përgjimet, ndryshim i cili gjithashtu është hartuar tashmë.

Neni 46

Komisioni i Pavarur i Rishikimit

BKH do të përfitojë nga asistenca dhe trajnimi i ofruar nga partnerët ndërkombëtarë, dhe si rrjedhojë do të ekzistojë një Komision i Pavarur Rishikimi, i përbërë nga ekspertë të drejtësisë penale të emëruar nga Misionet e Bashkimit Evropian dhe të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shqipëri. Ky Komision do të ofrojë udhëzime dhe këshilla për zhvillimin dhe përmirësimin e BKH-së, si dhe do të monitorojë rekrutimin, trajnimin si dhe vendimet për largimin e punonjësve të BKH-së.

KREU VI

PUNONJËSIT E GJYKATAVE KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE ORGANEVE TË SPECIALIZUARA TË STRUKTURËS SË POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR

Neni 47

Mbrojtja sipas shërbimit civil për punonjësit e gjykatave kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar dhe të Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar

Një masë e fortë për krijimin e një gjykate dhe prokurorie profesionale, si dhe për parandalimin e korrupsionit dhe veprimeve të tjera të papërshtatshme është të paturit e një personeli që ndihet i sigurtë në pozicionet e tij. Si personeli i Gjykatave kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, si ai i Prokurorisë së Posaçme, me përjashtim të gjyqtarëve dhe prokurorëve, u nënshtrohen dispozitave të ligjeve të tjera. Personeli jo-gjyqtar u nënshtrohet dispozitave përkatëse të Ligjit për Organizimin e Gjykatave, përveçse nëse parashikohet ndryshe në këtë ligj. Personeli jo-prokuror u nënshtrohen dispozitave përkatëse të Ligjit për Nëpunësin Civil, përveçse nëse parashikohet ndryshe në këtë ligj.

Neni 48

Standardet e sjelljes së punonjësve

Personeli i Gjykatave kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe i SPAK do të kërkohet të respektojnë standarde shumë të larta dhe do të kenë detyrimin e vazhdueshëm të bëjnë deklaram. Nëse nuk e respektojnë këtë detyrim, ata do të nënshtrohen masave disiplinore, pezullimit e deri në shkarkim. Personeli jo-gjyqtar i Gjykatave kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, personeli jo-prokuror i Prokurorisë së Posaçme dhe personeli jo-hetues i BKH-së do të jenë të detyruar të dorëzojnë deklarime financiare vjetore në Inspektoratin e Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe Konfliktin e Interesit. Ata do të jenë të detyruar t'i

dorëzojnë Oficerit Përgjegjës të BKH-së një deklaratë ku renditen anëtarët e familjes të vetë punonjësit dhe të bashkëshortit/es: fëmijët, nipërit/mbesat, motrat/vëllezërit, prindërit, gjyshërit, tezet/hallat, xhaxhallarët/dajat, kushërinjtë e parë, si dhe kushërinjtë e dytë. Ata kanë detyrimin e vazhdueshëm të deklarojnë përpara Drejtorit apo Oficerit Përgjegjës të Byrosë Kombëtare të Hetimit ose Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme çdo kontakt me persona të cilët i kanosin, u ofrojnë ryshfet apo para për të marrë informacion apo në këmbim të veprimeve që kanë lidhje me një hetim apo çështje të Zyrës. Ata kanë detyrimin e vazhdueshëm të ruajnë konfidencialitetin dhe sekretin e dëshmitarëve, provave, dokumenteve dhe të çdo informacioni tjetër në lidhje me hetimet e Prokurorisë së Posaçme, me përjashtim të rasteve kur këto informacione janë bërë publike tashmë në përputhje me ligjin.

KREU VII

SIGURIA E GJYKATAVE KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE PROKURORISË SË POSAÇME

Neni 49

Siguria e mjediseve

Gjykatat kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Prokuroria e Posaçme dhe BKH-ja do të kenë nevojë për sigurimin e ambienteve të tyre. Ky nen detyron shërbimet e sigurisë të Policisë së Shtetit të marrin masa për sigurimin, si dhe t'i raportojnë përkatësisht Kryetarit të Gjykatës përkatëse kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme dhe Drejtorit të BKH-së. Rregulla më të hollësishme në lidhje me sigurinë do të përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 50

Siguria e personelit

Ky nen përcakton detyrimet dhe kushtet për ofrimin e mbrojtjes personale, kur nevojitet, për gjyqtarët, prokurorët dhe punonjës të tjerë të Gjykatave kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe të SPAK. Ky nen ekziston në harmoni me një nen të ngjashëm tek projekt Ligji për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Rregulla të hollësishme mbi procedurat për ofrimin e sigurisë bazuar në këtë nen do të përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Disa ankesa të bëra në lidhje me mbrojtjen personale kanë qenë për faktin se punonjësit që caktohen për sigurinë personale zëvendësohen pa lajmëruar apo pa pëlqimin e personit të marrë nën mbrojtje. Ky nen e trajton këtë çështje duke detyruar që të merret pëlqimi i Kryetarit të Gjykatës, Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme apo Drejtorit të BKH-së për ndërrimin e oficerëve të mbrojtjes personale.

KREU VIII

KUSHTET E SIGURISË PËR BESIMIN DHE KONFIDENCIALITETIN

Neni 51

Heqja dorë nga të drejtat si kusht për caktimin në detyrë, emërimin dhe aksesin në informacion

Kandidatët për gjyqtarë dhe pozicione të tjera në Gjykatat kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, kandidatët për prokurorë dhe pozicione të tjera në Prokurorinë e Posaçme, kandidatët për Drejtor, zëvendës drejtor, hetues, oficer të Shërbimeve të Policisë Gjyqësore dhe pozicione të tjera në Byronë Kombëtare të Hetimit do të firmosin një deklaratë me shkrim për heqjen dorë nga e drejta e tyre për pritshmëri për privatësi në telekomunikimet e tyre dhe në të dhënat e tyre financiare. Kjo është në përputhje me Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, pasi nga këto të drejta privatësie mund të hiqet dorë, ose mund të jepet pëlqim për të lejuar një mbikëqyrje më ndërhyrëse. Edhe anëtarët e afërt të familjes, siç përkufizohet në Nenin 9 të këtij ligji, janë të detyruar të firmosin në shenjë të njohjes së këtyre kushteve. Kjo ka ndodhur edhe me gjyqtarët dhe prokurorët e USKOK në Kroaci dhe DNA në Rumani.

Heqja dorë nga këto të drejta lejon veprimet e përshkruara me hollësi në Nenet 54, 55 e 56.

Neni 52

Deklarimet dhe kontrollet fillestare për gjyqtarët, prokurorët, anëtarët e Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe anëtarët e afërt të familjes

Kandidatët për gjyqtarë dhe pozicione të tjera në Gjykatat kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, kandidatët për prokurorë dhe pozicione të tjera në Prokurorinë e Posaçme, kandidatët për Drejtor, zëvendës drejtor, hetues, oficer të Shërbimeve të Policisë Gjyqësore dhe pozicione të tjera në Byronë Kombëtare të Hetimit do të bëjnë deklaratime përpara se të emërohen apo caktohen me detyrë. Së pari, përpara se të emërohet apo caktohet, gjyqtari apo prokurori duhet të ketë qenë vlerësuar dhe kualifikuar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimeve. Në të kundërt, ata duhet të kenë kryer dhe kaluar me sukses një nivel të ngjashëm deklarimi.

Së pari, ata duhet të plotësojnë një deklaratë të re pasurie, në përputhje me Ligjin për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive, Detyrimeve Financiare të Personave të Zgjedhur dhe Disa Zyrtarëve Publikë, Ligji nr. 9049 (i ndryshuar). Kryeinspektori i Inspektoriatit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit bën llogaritjen e të ardhurave të ligjshme të familjes si dhe të pasurive faktike. Kandidati nuk ka të drejtë të emërohet në Gjykatat kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar apo në Prokurorinë e Posaçme nëse ka pasuri me vlerë më shumë se 133% e pasurive të cilat mund të shpjegohen nga të ardhurat e tij/saj të ligjshme. Gjithashtu, kandidati nuk ka të drejtë të emërohet as nëse nuk ka bërë një deklaram të saktë të pasurive të tij/saj.

Kandidatët do të plotësojnë një deklaratë personale, ku do të rendisin të dhënat jetësore, anëtarët e familjes, arrestimet apo dënimet, si dhe datat e udhëtimeve nga 1 janari 2010. Gjithashtu duhet të rendisin disa asete, përfshirë ato që i janë dhënë në përdorim. Në përdorim është një term i cili

përdoren në fushën ndërkombëtare të pastrimit të parave, i cili është përkufizuar në Nenin 9. Në këto raste, personi nuk është pronar i një pasurie apo prone, por i është dhënë përdorimi i kësaj pasurie apo prone. Kandidati duhet të rendisë çdo takim, marrëdhënie apo komunikim me persona të cilët, në dijeninë e tij/saj, janë arrestuar, dënuar apo akuzuar publikisht për krim të organizuar, me përjashtim të takimeve apo komunikimeve që kanë lidhje me pozicionin e tij në gjykatë apo prokurori.

Nëse kandidati apo familja e tij/saj kanë lidhje me krimin e organizuar, ata nuk kanë të drejtë të punojnë në Gjykatat kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar apo në Prokurorinë e Posaçme.

Neni 53

Deklarimet dhe kontrollet fillestare për punonjësit dhe anëtarët e afërt të familjes

Nuk janë vetëm prokurorët, gjyqtarët dhe hetuesit e BKH-së të cilët duhet të verifikohen për tu siguruar që nuk janë të korrumpuar apo të prirur për të nxjerrë informacion me subjektet e hetimeve. Përpara se një person të punësohet si pjesëtar i personelit të Gjykatave kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Prokurorisë së Posaçme apo BKH-së, ai/ajo duhet të ketë përfunduar dhe kaluar me sukses deklaratime të ngjashme me gjyqtarët dhe prokurorët. Së pari, ata duhet të plotësojnë një deklaratë të re pasurie, në përputhje me Ligjin për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive, Detyrimeve Financiare të Personave të Zgjedhur dhe Disa Zyrtarëve Publikë, Ligji nr. 9049 (i ndryshuar). Kryeinspektori i Inspektoriatit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit bën llogaritjen e të ardhurave të ligjshme të familjes si dhe të pasurive faktike. Kandidati nuk ka të drejtë të emërohet në Gjykatat kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar apo në Prokurorinë e Posaçme nëse ka pasuri me vlerë më shumë se 125% e pasurive të cilat mund të shpjegohen nga të ardhurat e tij/saj të ligjshme. Gjithashtu, kandidati nuk ka të drejtë të emërohet as nëse nuk ka bërë një deklaram të saktë të pasurive të tij/saj.

Kandidatët do të plotësojnë një deklaratë personale, ku do të rendisin të dhënat jetësore, anëtarët e familjes, arrestimet apo dënimet, si dhe datat e udhëtimeve nga 1 janari 2010. Gjithashtu duhet të rendisin disa asete, përfshirë ato që i janë dhënë në përdorim. Në përdorim është një term i cili përdoren në fushën ndërkombëtare të pastrimit të parave, i cili është përkufizuar në Nenin 9. Në këto raste, personi nuk është pronar i një pasurie apo prone, por i është dhënë përdorimi i kësaj pasurie apo prone. Kandidati duhet të rendisë çdo takim, marrëdhënie apo komunikim me persona të cilët, në dijeninë e tij/saj, janë arrestuar, dënuar apo akuzuar publikisht për krim të organizuar.

Nëse kandidati apo familja e tij/saj kanë lidhje me krimin e organizuar, ata nuk kanë të drejtë të punojnë në Gjykatat kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar apo në Prokurorinë e Posaçme.

Neni 54

Mbikqyrja e vazhdueshme

Kur kryetarët e gjykatave, gjyqtarët dhe personeli i Gjykatave kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Drejtuesi i Prokurorisë, prokurorët dhe personeli i Prokurorisë së Posaçme, dhe Drejtori, zëvendës drejtori, hetuesit, oficerët e shërbimeve të policisë gjyqësore dhe pozicionet e tjera në BKH, si dhe anëtarët e afërt të familjeve të tyre japin pëlqimin për mbikëqyrjen e vazhdueshme, kjo autorizon veprimet sipas këtij neni dhe neneve 55 e 56. Llogaritë financiare të subjekteve mbikëqyren në përputhje me Nenin 55. Telekomunikimet e tyre do të mbikëqyren në përputhje me Nenin 56.

Kush e kryen këtë mbikëqyrje? Oficerët Përgjegjës të Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe Njësia e Inteligjencës Financiare. Ky nen përshkruan këto masa, si dhe parashikon që dy Oficerët Përgjegjës të bashkërendojnë veprimtaritë e tyre dhe të takohen sipas nevojës, por jo më rrallë se një herë në muaj, për të diskutuar mbi veprimtari të dyshimta. Gjithashtu i detyron ata të raportojnë dyshime të arsyeshme tek çdo prokuror i Prokurorisë së Posaçme i cili nuk është i përfshirë në këto veprimtari.

Neni 55

Kontrollet dhe vëzhgimet që kryhen nga Drejtoria e Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave

Ka dy aspekte të mbikëqyrjes së vazhdueshme: mbikëqyrja e llogarive financiare dhe mbikëqyrja e telekomunikimeve. Ky nen parashikon kushtet për mbikëqyrjen e llogarive financiare që kanë kryetarët e gjykatave, gjyqtarët dhe personeli i Gjykatave kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Drejtuesi i Prokurorisë, prokurorët dhe personeli i Prokurorisë së Posaçme, dhe Drejtori, zëvendës drejtori, hetuesit, oficerët e shërbimeve të policisë gjyqësore dhe pozicionet e tjera në BKH, si dhe anëtarët e afërt të familjeve të tyre.

Kush e kryen këtë mbikëqyrje? Drejtoria e Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave cakton një punonjës të saj, në konsultim me Drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme, në rolin e oficerit përgjegjës që do të mbikëqyrë këto llogari financiare. Ky person do të ketë atributet e oficerit të policisë gjyqësore dhe do të ndërrohet me rotacion çdo 2 vjet.

Nëse Oficeri Përgjegjës ka dyshim të arsyeshëm për sa më poshtë, ai ia raporton atë një prokurori të Prokurorisë së Posaçme, i cili nuk është i përfshirë në shkelje:

- a. transaksione të mëdha financiare;
- b. modele të pazakonta transaksionesh financiare;
- c. transaksione financiare nga burime të pazakonta apo kriminale;
- ç. ekzistencë llogarish financiare të cilat nuk janë deklaruar.

Neni 56

Kontrollet dhe vëzhgimet që kryhen nga Byroja Kombëtare e Hetimit

Ka dy aspekte të mbikëqyrjes së vazhdueshme: mbikëqyrja e llogarive financiare dhe mbikëqyrja e telekomunikimeve. Ky nen parashikon kushtet për mbikëqyrjen e telekomunikimeve që kryhen

nga kryetarët e gjykatave, gjyqtarët dhe personeli i Gjykatave kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Drejtuesi i Prokurorisë, prokurorët dhe personeli i Prokurorisë së Posaçme, dhe Drejtori, zëvendës drejtori, hetuesit, oficerët e shërbimeve të policisë gjyqësore dhe pozicionet e tjera në BKH, si dhe anëtarët e afërt të familjeve të tyre.

Kush e kryen këtë mbikëqyrje? Oficeri Përgjegjës i Byrosë Kombëtare të Hetimit. Ai/ajo harton një plan për shqyrtimin çdo muaj të komunikimeve telefonike, mesazheve apo postës elektronike të subjekteve të mbikëqyrjes. Ky plan nuk bëhet publik, pasi kjo mund t'i bënte të mundur dikujt të përgatitej apo parashikonte mbikëqyrjen e tij/saj dhe, çka është më e rëndësishme, do të dinte kur nuk do të mbikëqyrej. Plani do të ndryshohet çdo tre muaj.

Oficeri Përgjegjës nuk dëgjon telefonatat që shkelin të drejtën për jetë private të personave që nuk kanë dhënë miratim paraprak për mbikëqyrjen. Nëse Oficeri Përgjegjës ka dyshim të arsyeshëm se ka ndodhur apo do të ndodhë një veprë penale dhe se mbikëqyrja e asaj telefonate me persona që nuk kanë dhënë miratim paraprak do të japë prova për këtë veprë penale, ai do të kontaktojë menjëherë një Prokuror të Posaçëm të përfshirë në shkelje, për të marrë autorizim nga gjykata.

Neni 57

Mbrojtja e të dhënave

Ky nen thjesht kërkon që të dhënat personale të marra gjatë mbikëqyrjes së vazhdueshme të ruhen në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Neni 58

Raportimi i informacionit dhe provave tek një prokuror jo i përfshirë i Prokurorisë së Posaçme

Ky nen detyron oficerët përgjegjës të BKH-së dhe të Njësisë së Inteligjencës Financiare të raportojnë çdo shkelje që zbulojnë tek një prokuror i Prokurorisë së Posaçme i cili nuk është i përfshirë në shkelje.

Bazuar në këtë raport, Prokurori i Posaçëm do të nisë një hetim, pa kërkuar miratim nga asnjë autoritet tjetër.

Neni 59

Shkarkimi për shkeljen e kushteve të besimit dhe konfidencialitetit

Ky nen merret me sekretin dhe konfidencialitetin e një hetimi të rëndësishëm penal. Ky nen parashikon që nëse një gjyqtar i Gjykatave kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, apo prokuror i Prokurorisë së Posaçme ka nxjerrë informacion sensitiv, qoftë nga pakujdesia apo me qëllim, ai person mund të shkarkohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor apo Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Nëse një tjetër punonjës i Gjykatave kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar,

Prokurorisë së Posaçme, apo Byrosë Kombëtare të Hetimit ka nxjerrë informacion sensitiv, qoftë nga pakujdesia apo me qëllim, ai person mund të shkarkohet.

KREU X DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 60 Buxheti fillestar

Ky nen thjesht parashikon caktimin nga Këshilli i Ministrave të një buxheti fillestar për Gjykatat kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Prokurorinë e Posaçme, dhe Byronë Kombëtare të Hetimit, i cili miratohet me ligj të posaçëm për buxhetin. Të gjithë buxhetet e mëvonshëm përcaktohen në përputhje me këtë ligj.

Neni 61 Dispozita kalimtare

Ky nen, si edhe nenet në projektligjet e tjera, japin dispozitat e nevojshme kalimtare për të zbatuar projekt-ndryshimet kushtetuese dhe për të krijuar Gjykatat kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Prokurorinë e Posaçme dhe Byronë Kombëtare të Hetimit.